



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 43/4 prot.

Tiranë më, 29.01 / 2020

VENDIM

Nr. 5, datë 29.01.2020

“Për fillimin dhe miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e administratorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike”

Në bazë të nenit 51, pika 2, e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përzgjedhjen e administratorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike.
2. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e administratorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Protokollin e ASA-së për publikimin e kriterëve në Buletinin e APP-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, _____ 2020

**KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E ADMINISTRATORIT TË AKADEMISË SË
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

- A. Kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
1. Të jetë shtetas shqiptar;
 2. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në fushën e drejtësisë ose ekonomisë së paku niveli "Master i shkencave";
 3. Të ketë përvojë pune së paku 7 vjet në këto fusha;
 4. Të mos ketë lidhje ose konflikt interesi me drejtuesit e Akademisë dhe Bordit të Administrimit;
 5. Të ketë trajnime dhe/ose kualifikime të ndryshme në fushën përkatëse;
 6. Të zotërojë të paktën 1 gjuhë të huaj;
 7. Të mos ketë shkaqe për të kandiduar në zbatim të ligjit nr. 138/2015;
 8. Të mos jetë larguar nga punët e mëparshme me masë disiplinore.
 9. Të vërtetojë që është i aftë për punë.
- B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Letër motivimi për pozicionin e punës për të cilin konkurren (origjinal);
 2. Fotokopje e noterizuar e dokumentit të identifikimit;
 3. Curriculum vitae me fotografi (origjinal);
 4. Fotokopje e noterizuar e diplomës/diplomave e shoqëruar me listat e notave përkatëse. Kandidati që ka përfunduar studimet jashtë vendit, duhet të paraqesë njohjen e diplomës nga MASR/QSHA.
 5. 1 (një) letër reference nga punëdhënësi i mëparshëm (origjinale);
 6. Deklaratë që nuk ka konflikt interesi me drejtuesit e Akademisë dhe anëtarët e Bordit (origjinale);
 7. Fotokopje të noterizuar e librezës së punës që vërteton përvojën e punës;
 8. Formularin e vetëdeklarimit ku vërtetohet që nuk është i dënuar ose në proces gjyqësor në zbatim të ligjit nr. 138/2015 (origjinal);
 9. Fotokopje të noterizuar e certifikatave të trajnimeve ose/dhe kualifikimeve;
 10. Fotokopje të noterizuar të dëshmisë/dëshmime të gjuhëve të huaja nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ose nga provime ndërkombëtare të certifikuara;

11. Vërtetimi i gjendjes shëndetësore (original).

C. Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është data 29.02.2020.

D. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës brenda afatit të parashikuar në pikën C më sipër, në adresën:

Akademia e Studimeve Albanologjike
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 3, Tiranë

E. *Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.*

F. *Procedura e përzgjedhjes së kandidatave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*